


FUQIZIMI DHE ZGJERIMI I AKTIVITETEVE TË RRJETIT “ZËRI I TË RINJVE”:

Bashkia Shkodër - Histori Suksesi

Ky dokument u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve me mbështetjen e UNFPA-së, në emër të rrjetit të organizatave “Zëri i të rinjve”.

Shtator 2018



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Kjo analizë u realizua në kuadër të zbatimit të programit "Për ngritjen, koordinimin dhe zgjerimin e platformës advokuese të shoqërisë civile mbi çështjet e Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qendrushëm (SDGs)". Publikimi u realizua me mbështetjen e " Fondit për Rezultate të Përbashkëta nga UN DOCO".

EKIPI MENAXHUES

Elma Tërshana

Eridjona Vallja

Andi Rabiaj

Albana Kastrati

SUPERVIZUESE

Elida Nuri

Një falenderim i shkon stafit të Bashkisë së Shkodrës që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundësuar të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar dhe realizuar për të rejat dhe të rinjtë. Në veçanti falenderojmë Znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër, Z. Filip Vila, Drejtor i Shërbimeve Sociale dhe Znj. Lorena Bardeli, Specialiste e Shëndetit Publik.

Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinonet e shprehura këtu janë të autorëve/eve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së.

FUQIZIMI DHE ZGJERIMI I AKTIVITETEVE TË RRJETIT “ZËRI I TË RINJVE”: Bashkia Shkodër - Histori Suksesi

“Investimi real dhe i dedikuar në përfshirjen e të rejave dhe të rinjve - drejtim kryesor i punës së Bashkisë Shkodër”

Edhe pse rinia në Shqipëri është pjesë e programit dhe politikave të qeverisë dhe citohet si grup prioritar në dokumenta të veçantë të hartuar për këtë qëllim, **aktivizimi i të rejave dhe të rinjve në praktikë dhe përfshirja e tyre në bashkëqeverisje, kërkon gërshetim të vëmendjes, veprimeve dhe burimeve - sidomos financiare - të dedikuara realisht nga qeverisja qendrore në bashkëpunim me atë vendore.** Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, qartësisht evidenton nevojën për “përmirësim të cilësisë së jetës së të rejave e të rinjve dhe forcim të statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe rritje të pjesëmarrjes së plotë të tyre në shoqëri dhe vendim-marrje”.

Por **përmbushja e këtij misioni në praktikë, mbetet larg realitetit nëse nuk ndërmerren hapa konkretë, sidomos nga njësitë e vetëqeverisjes vendore,** për të cilat detyrimi dhe përgjegjësia për trajtimin me prioritet të rinisë shprehet qartësisht edhe në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (kryesisht në nenet 22-30 që evidentojnë parimet për ushtrimin e funksioneve në fushat e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese, si dhe në një sërë fushash të tjera).

Bashkia Shkodër, është një nga njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk ka humbur kohë për hedhjen e hapave konkretë në këtë drejtim. Të rejat dhe të rinjtë janë grup i synuar dhe prioritet për këtë bashki, pasqyruar si në plane të përgjithshme e të veçanta, ashtu edhe në shifra konkrete, të buxhetuara e shpenzuara rregullisht këto tre vitet e fundit.

Në përputhje me parimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e saj për ushtrimin e kompetencave dhe të funksioneve të ndryshme sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **Bashkia Shkodër, u jep çdo vit e më tepër përparësi veprimeve të veçanta për përfshirjen dhe adresimin e nevojave të të rejave dhe të rinjve,** përmes: (i) shërbimeve dhe programeve të caktuara të kujdesit shëndetësor parësor, (ii) rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor; (iii) aktiviteteve edukuese dhe promovuese për mbrojtjen e shëndetit në 10 (dhjetë) qendrat komunitare për familjen, 5 (pesë) nga të cilat të lokalizuara në qytet dhe 5 (pesë) në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Rrethina, Velipojë dhe Shalë; (iv) realizimit të seancave të konsultimit me qytetaret/ët dhe të rejat/të rinjtë, si dhe seancave dëgjimore nga Këshilli Bashkiak për problemet e shëndetit dhe rinisë; (v) vënies në dispozicion të burimeve të caktuara të kontaktimit, ku të rejat/të rinjtë mund të prononcohen dhe adresojnë problemet e tyre; (vi) përmirësimit të kuadrit rregullativ dhe financiar në drejtim të shërbimeve dhe masave për rininë dhe shëndetin, si dhe (vii) parashikimit dhe shpenzimit të fondeve të caktuara në planet buxhetore të përvitshme, për këtë qëllim.

Aktivitetet informuese dhe sensibilizuese për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, për shëndetin seksual dhe riprodhues, krijimi i bordeve apo këshillave të përbashkët konsultues mes bashkisë dhe organizatave rinore, si dhe mbajtja e regjistrit statistikor vendor për sëmundje që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe shëndetin e të rejave/të rinjve, klasifikohen nga Bashkia Shkodër si **prioritete kryesore** të saj. Këto pasohen edhe nga pasja e një manuali për të rejtat/të rinjtë për të njohur të drejtat e tyre të parashikuara nga legjislati aktual në lidhje me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, ofrimi i kujdesit të rritur nga ana e bashkisë për këto shërbime krahasuar me shërbimet e tjera vendore, si dhe shkëmbimi i eksperiencës me të reja/të rinj nga bashkitë e tjera, me ndërmjetësimin e drejtues/eve vendor/e.

Ajo çka e bën historinë e Bashkisë Shkodër, një model të suksesshëm dhe shembull për t'u ndjekur edhe nga bashki të tjera në vend, është **rritja në vlera tepër të konsiderueshme, sidomos këto tre vitet e fundit, e parashikimit të zërave buxhetorë të tre drejtorive kryesore** (Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik), **të cilat kanë në fokus të rejtat/të rinjtë dhe shërbimet e ndryshme ndaj tyre**. Kështu, **parashikimi buxhetor për këto tre drejtori së bashku, që në vitin 2015 rezultonte në vlerën 117,762 lekë, u rrit me gati trefishin e vlerës në vitin 2016 dhe me mbi dymbëdhjetëfishin e të njëjtës vlerë në vitin 2017, duke arritur kështu në shifrën e 1,468,960 lekëve**. Ndërkohë që **shpenzimi i fondeve në total po për këto tre drejtori për vitin 2016 e tejkalon planifikimin e bërë në masën 313%** (duke u harxhuar një vlerë prej 1,096,610 lekësh ku peshën më të madhe të shpenzimeve e zinte Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve). Ndërsa **shpenzimi i fondeve në total për këto tre drejtori për vitin 2017 ka një diferencë (të shpenzuar) në masën 45% të vlerës së buxhetit të planifikuar** (shpenzuar rreth 803,798 lekë), çka tërhoqi vëmëndjen e bashkisë për një buxhetim më të kujdesshëm dhe real për t'u shpenzuar, për vitet në vijim. Kështu, parashikimi buxhetor për këto tre drejtori për vitin 2018 është rritur me vetëm 1.04% më shumë të vlerës krahasuar me vitin 2017 (ose me mbi trembëdhjetëfishin e vlerës së planifikuar në vitin 2015) dhe rezultojnë në shumën 1,534,120 lekë.

Realizimi i veprimeve të planifikuara dhe buxhetuara nga Bashkia Shkodër për përmirësimin e informimit, edukimit dhe cilësisë së jetesës së të rejave dhe të rinjve, për vitin 2017, shënon këto rezultate kryesore:

- (i) **14 (katërmëdhjetë) aktivitetete sportive, kulturore, informuese, sensibilizuese, si dhe edukuese, me tematika të ndryshme sociale, për të drejtat, familjen dhe fuqizimin e rolit të rinisë në shoqëri, realizuar me pjesëmarrjen jo vetëm të të rejave dhe të rinjve shkodranë, por edhe të atyre nga Ulqini e bashki të tjera fqinje;**
- (ii) **50 (pesëdhjetë) takime informuese dhe sensibilizuese me synim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës dhe parandalimin e sëmundjeve në komunitet, të realizuara me pjesëmarrjen në total të 802 të rejave dhe të rinjve;**
- (iii) **baza e të dhënave mbi gjendjen infrastrukturore të qendrave shëndetësore në komunitet e përgatitur dhe raporti mbi funksionimin e këtyre qendrave, i gatshëm për t'u përdorur;**
- (iv) **është ngritur dhe vënë në funksionim Qendra Komunitare "Për Familjen" në Njësinë Administrative Shalë, në Theth, duke e çuar kështu në 10 (dhjetë) numrin e Qendrave Komunitare "Për Familjen" të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet;**
- (v) **është përfunduar plani i komunikimit për Qendrën Rinore dhe baza e të dhënave për nevojat e të rejave dhe rinjve në bashkinë e Shkodrës, si dhe mundësitë që ofrohen për to në territor;**
- (vi) **ka filluar rikonstruksioni dhe pajisja e Qendrës së parë Rinore Publike në Bashkinë Shkodër;**

(vii) është siguruar qëndrueshmëria e bandës muzikore të përbërë nga 30 fëmijë me nevoja të veçanta dhe është siguruar pjesëmarrja e tyre në dy shfaqje konkrete;

(ix) 11 student/e të Universitetit të Shkodrës, konkretisht 6 (gjashtë) nga dega e Psikologjisë dhe 5 (pesë) nga dega e Punës Sociale, ndjekin rregullisht praktikën mësimore profesionale pranë Bashkisë Shkodër, duke u bërë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara veçanërisht me Qendrat Komunitare.

Për rredhë, jeta sportive, artistike dhe kulturore e të rejave dhe të rinjve të Bashkisë Shkodër dhe njësive administrative të saj është gjallëruar ndjeshëm, ka një rritje të nivelit të informacionit dhe njohurive që transmetohen për rininë në fusha të ndryshme të veprimit të bashkisë, si dhe vihet re një aktivizim i dukshëm i vetë të rejave dhe të rinjve, shoqëruar me dëshirë më të madhe për pjesëmarrje në debate, diskutime e procese vendim-marrëse në shoqëri.

Bashkia Shkodër do t'i kushtojë vëmendje të veçantë gjatë vitit 2018 rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së veprimeve të planifikuara për të rejat dhe të rinjtë, si dhe përmirësimit të kosto-efiçencës së zbatimit të këtyre veprimeve.

Vështirësitë apo sfidat e ndeshura dhe mënyrat e kapërcimit të tyre sigurojnë që shërbejnë si mësim për vijimin e punës në të ardhmen dhe Bashkia Shkodër tregon mjaft kujdes në mbajtjen e tyre në konsideratë. Por, një nga mësimet kryesore udhëheqëse të punës së saj në këtë drejtim mbetet investimi konkret për të rejat dhe të rinjtë përmes planifikimit, vënies në dispozicion, buxhetimit dhe shpenzimit real të burimeve të duhura njerëzore, infrastrukturore e financiare, për realizimin e veprimeve efektive, me kosto efiçencë të përmirësuar dhe të qëndrueshme, nën moton **"Rinia, e ardhmja e qytetit tonë!"**

Aneks 1

Lista e aktiviteteve dhe veprimeve të realizuara nga Bashkia Shkodër, në lidhje me përmirësimin e jetës dhe kushteve të të rejave dhe të rinjve shkodranë, për vitin 2017.

- Aktiviteti sportiv ("Beach Volley") i organizuar në datat 25-26-27 gusht, ku përveç sportiest/eve profesionist/e, kishte edhe pjesëmarrje të madhe nga të reja dhe të rinj pushues.
- Kampi veror më të reja dhe rinj nga Evropa të cilat/ët dhanë kontributin e tyre në programet rinore, organizuar në muajin gusht, në bashkëpunim me shoqatën "Go 4 Peace".
- Seminari me titull "Në vendin tonë vendosim edhe ne", organizuar në muajin tetor në mjediset e hotel "Rozafa", në bashkëpunim me Shoqatën "Konrad Adenauer", me fokus përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në vendim-marrjen e qeverisjes vendore.
- Nata finale e "Fjalës Artistike" organizuar në datën 22 nëntor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve. "Kampionati i lojërave me dorë" mes shkollave të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Sport Klub Vllaznia, zhvilluar në datat 25-26 nëntor.
- "Maratona e Pavarësisë Ulqin-Shkodër" ku marrin pjesë qindra të reja dhe të rinj jo vetëm nga Shkodra, por edhe më gjerë, si aktivitet përmbyllës edhe i "Javës së Pavarësisë".
- Gjashtë aktivitete sensibilizuese me qëllim promovimin e vlerave të familjes dhe shërbimeve që ofrohen në fuqizim të familjes biologjike, apo promovimit të shërbimeve alternative me qëllim deinstitutionalizimin dhe parandalimin e institucionalizimit, organizuar të gjitha në kuadër të "Javës së Familjes".
- Aktiviteti sensibilizues për promovimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, realizuar në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve dhe shkollat 9 vjeçare (aktivitet social, kulturor, sensibilizues dhe një panair me punimet e fëmijëve dhe të rejave e të rinjve në institucionet rezidenciale dhe të organizatave të shoqërisë civile).
Gjashtë aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin, në Qendrat Komunitare "Për Familjen", të organizuara në javën e Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
- Aktiviteti "Lojëra Popullore Fest", me synim kryesor ruajtjen, promovimin dhe përcimin e traditave kulturore tek brezat e rinj, nëpërmjet angazhimit tyre konkret në këtë aktivitet, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha trevat shqiptare, që u zhvillua në sallën e aktiviteteve të Shkollës Artistike "Prekë Jakova".
- Gjashtëmbëdhjetë takime informuese dhe sensibilizuese organizuar në ditët ndërkombëtare të shëndetit, me synim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës dhe parandalimin e sëmundjeve në komunitet.
- Përgatitja e bazës së të dhënave mbi gjendjen infrastrukturore të qendrave shëndetësore në komunitet, si dhe i vlerësimit të nevojës dhe funksionalitetit të qendrave shëndetësore parësore, kompletuar me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje.
- Pesëdhjetë takime me tematikë mbi shëndetin dhe të rinjtë, të organizuara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", në shkollë, në qytet dhe në njësitë administrative Dajç, Guri i Zi, Postribë dhe Bërdicë.
- Baza e të dhënave mbi gjendjen infrastrukturore të qendrave shëndetësore në komunitet e përgatitur dhe raporti mbi funksionimin e këtyre qendrave, i gatshëm për t'u përdorur. Është ngritur dhe vënë në funksionim Qendra Komunitare "Për Familjen" në Njësinë Administrative Shalë, në Theth, duke e çuar kështu në 10 (dhjetë) numrin e Qendrave Komunitare "Për Familjen" të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet.

- Është përfunduar plani i komunikimit për Qendrën Rinore dhe baza e të dhënave për nevojat e të rejave dhe rinjve në bashkinë e Shkodrës, si dhe mundësitë që ofrohen për to në territor.
- Ka filluar rikonstruksioni dhe pajisja e Qendrës së parë Rinore Publike në Bashkinë Shkodër.
- Është siguruar qëndrueshmëria e bandës muzikore të përbërë nga 30 fëmijë me nevoja të veçanta dhe është siguruar pjesëmarrja e tyre në dy shfaqje konkrete.
- 11 student/e të Universitetit të Shkodrës, konkretisht 6 (gjashtë) nga dega e Psikologjisë dhe 5 (pesë) nga dega e Punës Sociale, ndjekin rregullisht praktikën mësimore profesionale pranë Bashkisë Shkodër, duke u bërë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara veçanërisht me Qendrat Komunitare.

Aneks 2:

Tabela e burimeve financiare të parashikuara dhe realizuara përgjatë periudhës 2015-2018 nga tre drejtori të Bashkisë Shkodër (Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik):

Viti	Parashikuar në vit (lekë)	Masa e rritjes së buxhetit çdo vit, krahasuar me vitin 2015 (%)	Realizuar në vit (lekë)	Raporti i realizimit mbi parashikimin (%)
2015	117,642	n/a	n/a	
2016	350,271	2.98	1,096,610	313
2017	1,468,960	12.49	803,798	45
2018	1,534,120	13.04	n/a	n/a

Informacion shtesë mbi buxhetin, mund të gjendet në:

- http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Buxheti_162_1.php

- http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Buxheti_i_vitit_2017_d-he_afatmesem_i_vitit_2018_2019_769_1.php

